

AKTI I THEMELIMIT
PER KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
GRACE AGRITOURISM AND DIVERSITY SH.P.K

EMRI I SHOQERISE:

Emri i shoqerise eshte Grace Agritourism and Diversity Sh.P.K;

Emri I shkurtuar është “GAD”shpk

Vula e shoqërisë është GAD shpk dhe figura e globit/tokës.

SELIA E SHOQERISE:

Selia e Shoqerise eshte ne fshatin Gracë, Nd. Nr. 1, Rruga “Fusha e Sportit”,
Njësia Administrative Hoçisht, 7009, ZK. 1833 Devoll.

Veprimtaria e **Grace Agritourism and Diversity Sh.P.K** do te shtrihet ne te
gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe jashte saj.

AFATI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE:

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj dhe vepron si person juridik me personalitet te
plote per te vepruar per nje kohe te pacaktuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE:

Grace Agritourism and Diversity Sh.P.K ka si objekt kryerjen e te gjitha aktiviteteve
qe nje kompani me pergjegjesi te kufizuar mund te kryeje ne perputhje me legjislacionin
shqiptar, brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, perfshire por pa u
kufizuar ne: Agroturizësm; Ndermarrje Bujqesore për shfrytëzimin e tokës dhe ujit duke
ushtruar dhe promovuar peshkimin çlodhës, peshkimin amator të kohës së lirë,
kultivimin, mbledhjen dhe tregtimin e peshkut në basene ujore natyrale ose të krijuara
duke shfrytëzuar racionalisht dhe duke ruajtur diversitetin biologjik dhe minimalizuar
ndikimet në ekosistemin ujor për të ruajtur/promovuar zinxhirin ushqimor, ruajtjen e
klimës dhe mjedisit, nëpërmjet studimeve, trajnimeve apo bashkëpunimeve me
institucione, shoqata apo organizma të tjerë.

Agroturizem, stukturë akomoduese, veprimtari pritesë, mbarështrimin e peshkut,
blegtorisë, shpendëve, pemëve frutore dhe dekorative. Organizimi i eventeve dhe
ceremonive festive, sociale, kulturore për të gjitha moshat sipas përcaktimeve ligjore,

Melsi Agollu
Mar

duke promovuar barazinë gjinore në zonën e Devollit dhe në të gjithë Shqipërinë, nëpërmjet punësimit të grave dhe vajzave, drejtimin drejt punësimit të rinjve, përkrahjen e artizanatit, punëve të dorës, prodhimeve tradicionale të zonës, ruajtjen e traditës ndër breza mes ndërveprimit, bashkëpunimit, promovimit, specializimit dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese.

Rritjen e aksesit, qëndrueshmërisë, aftësive dhe përdorimit të TIK-ut, rritjen e bazës së njohurive socio-ekonomike të sektorit duke promovuar zonën si një destinacion unik për përfshirja e turizmit në vend. Rritja e mundësive të udhëtimit të disponueshme për njerëzit me nevoja të veçanta aksesit të cilat promovojnë përfshirjen sociale dhe përmirësimin e aftësive e stafit në agrobiznes. Ndërmjetësim për lidhje kontratash midis agjentëve tregtarë shqiptarë apo të huaj, për tregtimin e produkteve vendase..

Zhvillimi i bletarise, shtimi dhe mbarështrimi i tyre.

Organizimi i guidave turistike. Organizimi i trajnimeve dhe seminareve për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve, flores dhe faunes në zonë.

Aktivitet në Agroturizem dhe turizem rural. Akomodimi dhe ofrim ushqimesh dhe pije. Aktivitete dhe shërbime për arëtim, shpëlodhje, turizem të natyres. Shërbime dhe aktivitete të ndryshme sportive në kuader të kërkesave të turistëve , ciklizem, ecje në mal, ecje në natyrë, krijimi i shtigjeve të reja për promovimin dhe njohjen me zonën e juglindjes së Shqipërisë për të tërhequr vizitorë, vendas e të huaj.

Marrje me qira, në huapërdorje dhe shitje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme për zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë.

Import – Export: të rasat peshku, farerave, fidaneve, bimeve, gjethëve, shpendëve, makinerive të përpunimit bujqësor, ushqimor, blektorale, shpendëve, bimeve mjeksore, ushqime peshku, Nutrients për perime, peme frutore, Produkte ambalazhimi për prodhime bujqësore, blektorale dhe peshkimi, fertilizimi dhe plehra organik dhe inorganik. Pajisje për sisteme hidroponike substrakte të ndryshme, Pajisje për sera ventilator, filtra uji, sisteme elektrike ndricues me spektrum të plotë . Blerje- shitje të produkteve e nënprodukteve bujqësore, blektorale, frutikulturë (pemtarië), shpendëve dhe të bimeve medicinale.

KAPITALI.

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë ka një vlerë prej 100.000 (një qind mijë) leke.

NUMRI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR TE NENSHKRUAR

Numri i pjesëve të kapitalit themeltar të nënshkruar është 1 (një) ndarë në 1 kuotë.

VLERA NOMINALE E SECILES PJESE TE KAPITALIT THEMELTAR TE NENSHKRUAR

Vlera nominale e kuotës të kapitalit themeltar të nënshkruar është 100.000 leke (njëqind mijë leke.) I ndarë në 1 kuotë.

Meksi Apollu


PJESEMARRJA NE KAPITALIN THEMELTAR TE NENSHKRUAR

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkuar eshte 100 % nga Z.Melsi Agolli.

VLERA DHE LLOJI I KONTRIBUTIT TE ORTAKUT TE VETEM

Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, kapitali i Shoqesie eshte i zoteruar teresisht nga ortaket: 1 . Melsi Agolli ,eshte zoterues i 1 kuote me 100% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise me vlere 100.000 leke. Lloji i kontributit te ortakut te vetem eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”

Kapitali fillestar i nenshkuar eshte paguar nga ortaku i vetem ne menyre te rregullt, plotesisht dhe rregullisht.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise (Agroturizëm).

Ortaku/ortaket e shoqerise perballojne humbjen deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre.

BAZA LIGJORE

Shoqeria Grace Agritourism and Diversity Sh.P.K e ushtron veprimtarinë e saj bazuar në ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ” I ndryshuar; Ligjin Nr. 64/2012 “Për Peshkimin”; LIGJ Nr. 93/2015 “Për Turizmin”; Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (I ndryshuar); Ligji Nr.9115, date 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” (I ndryshuar); Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” (I ndryshuar); Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (I ndryshuar); LIGJ Nr.9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”

DISPOZITE E FUNDIT

Ndryshimet ne Aktin e Themelimit mund te behen vetem me shkrese dhe te miratuar nga asambleja e ortakeve.

Melsi Agolli


Pjese e pandare e ketij akti eshte statuti i shoqerise i cili nenshkuhet rregullisht nga themeluesit e shoqërisë.

Ky akt themelimi u hartua ne Devoll në datë 27.06.2022, në 5 kopje origjinale, i cili nenshkruhet rregullisht konform ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ” I ndryshuar.

THEMELUESE

MELSI AGOLLI

Melsi Agolli
